



BASHKIA

TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

Drejtuar: Operatori ekonomik “Gentian Horieti” person fizik
Adresa: Rruga 5 Maji, ish NPK, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e Prokurimit:”Kërkesë për Propozim” “Lyerje e ambjenteve te Konvikteve të Shkollave të Mesme për vitin 2018”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-69122-05-15-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës:: Qëllimi i kontratës është ”Lyerja e ambjenteve të brendshme të katër Konvikteve të Shkollave të Mesme ”Konvikti i Hoteleri Turizëm”, ”Konvikti i ekonomikut”, ”Konvikti i mjeshtrese sportive”, ”Konvikti elektrik”, **Tirane.**

Fondi Limit: 3.642.312 (tremilion e gjashtëqind e dyzet e dymijë e treqind e dymbë dhjetë) lekë pa tvsh

Burimi i financimit:Fond i vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 132, datë 21.12.2017, për “Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

Publikime te mepareshme : Buletini i Njotimeve **Nr.20, date 21 Maj 2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat perkatase te ofruara:

1- Operatori ekonomik “ **Erges Mat** ” sh.p.k **NIPT K71614913O**

Vlera e ofertës = **2.028.420 (dymilion e njëzet e tetëmijë e katërqind e njëzet)** lekë pa TVSH

2- Operatori ekonomik “ **Doksani - G**” sh.p.k **NIPT L21809501H**

Vlera e ofertës = **2.070.724 (dymilion e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e katër)** lekë pa TVSH.

3- Operatori ekonomik “**Meni**” sh.p.k **NIPT J61909018W**

Vlera e ofertës = **2.106.086** (dymilion e njëqind e gjashtëmijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

4- Operatori ekonomik "Hysi-2F" shpk

NIPT K72429007E

Vlera e ofertës = **2.221.152** (dymilion e njëqind e njëzet e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

5- Operatori ekonomik "Cara" sh.p.k

NIPT K07729920F

Vlera e ofertës = **2.357.180** (dymilion e treqind e pesëdhjetë e shtatëmijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

6 -Operatori ekonomik "THEOS " sh.p.k

NIPT J61828056L

Vlera e ofertës = **2.503.984** (dymilion e pesëqind e tremijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

7- Operatori ekonomik "Altec " sh.p.k

NIPT K57923807W

Vlera e ofertës = **2.592.660** (dymilion e pesëqind e nëntëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

8- Operatori ekonomik "2 N" sh.p.k

NIPT L31615017L

Vlera e ofertës = **2.620.750** (dymilion e gjashtëqind e njëzetmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

9- Operatori ekonomik "Deutchcolor" sh.p.k

NIPT L21326504J

Vlera e ofertës = **2.770.686** (dymilion e shtatëqind e shtatëdhjetëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

10- Operatori ekonomik "Tea-D" sh.p.k

NIPT K32522629L

Vlera e ofertës = **2.804.560** (dymilion e tetëqind e katërmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

11- Operatori ekonomik "O.B.Konstruksion" sh.p.k

NIPT K93728201H

Vlera e ofertës = **2.805.150** (dymilion e tetëqind e pesëmijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

12- Operatori ekonomik "2 Z Konstruksion" sh.p.k

NIPT J63229466K

Vlera e ofertës = **2.983.320** (dymilion e nëntëqind e tetëdhjetë e tremijë e treqind e njëzet))
lekë pa TVSH.

13- Operatori ekonomik “Gentian Horieti” person fizik

NIPT K31427013J

Vlera e ofertës = **3.476.346** (tremilion e katërqind e shtatedhjetë e gjashtëmijë e treqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik “Erges Mat” shpk

- a) Operatori ekonomik “Erges Mat” ka paraqitur katalogun e bojrave Deluxe dhe specifikimet teknike te ketyre bojrave por nuk ka paraqitur raportet e testimit nga laboratore te certifikuar ku të vërtetohet se specifikimet teknike të bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
- Ne folderin me emertimin ” Kataloge_Daylux0001 (1)” ndodhen keto dokumenta;
 - a)-Katalogu i bojes plastike te markes “Golden ECO PLAST” te firmes prodhuese “Daylux”
 - Ne folderin me emertimin ” Kataloge_Daylux0001” ndodhen keto dokumenta;
 - a)-Foto te markave ”Super lac enamel paint”, ”Over lac”, ”Golden ECO PLAST”, ”Super ECO PLAST” dhe ”Platin” pa asnje te dhene apo specifikim teknik.
 - Ne folderin me emertimin ” Skeda_teknike” ndodhen keto dokumenta;
 - a)-Skeda teknike e astarit plastik te markes “Emulsion Primer” te firmes prodhuese “Daylux”
 - b)-Skeda teknike e bojes plastike te markes “Super ECO PLAST” te firmes prodhuese “Daylux”
 - c)- Skeda teknike e bojes plastike te markes “Golden ECO PLAST” te firmes prodhuese “Daylux”
 - Ne folderin me emertimin ” Skeda_-raport_bojes_Daylux” ndodhen keto dokumenta;
 - a)-Nje dokument ne gjuhe te huaj per te cilin ju pretendoni se eshte raport testimi per bojen plastike te markes “Golden ECO PLAST”.

2. Operatori ekonomik “Doksani-G” shpk

- a. Operatori ekonomik “Doksani-G” shpk nuk ka paraqitur vertetim nga administrata tatimore per xhiron mesatare vjetore te realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.1.1.
- b. Operatori ekonomik “Doksani-G” shpk ka paraqitur katalogun e bojrave Doromix por nuk ka paraqitur raportet e testimit nga laboratore te certifikuar ku te vërtetohet se

specifikimet teknike te bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor ne shtojcen 8 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

3. Operatori ekonomik “Meni” shpk

Referuar Nenit 12 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, date 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” ligjvënësi përcakton sa më poshtë: “Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit publik. Ky informacion përfshin: emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor dhe të personit/ave përgjegjës për procedurën; objektin; referencën e njoftimit dhe procedurën e prokurimit; vlerën limit të përlogaritur të kontratës dhe kohëzgjatjen e kontratës; një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotetnëse përdoren; kriteret e shpalljes së fituesit; kushtet e marrëveshjes kuadër; vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet; vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre; gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve; informacione të mëtejshme të vlerësuara të dobishme nga autoriteti kontraktor”

Në njoftimin e kontratës pika 4.6 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar sa me poshte:

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip
Tjetër

X

Anglisht

Pra sa më sipër Paraqitja e këtyre dokumentave të papërkthyer në gjuhën shqip bie në kundërshtim me pikën 4.6 të Njoftimit të Kontratës në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: “Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëhere dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe” si dhe me Nenin 12 te Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, date 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” referuar të cilit Autoriteti Kontraktor si gjuhe të ofertave dhe dokumentave ka përcaktuar gjuhën shqipe.

Komisioni i vleresimit te ofertave gjykon se katalogët dhe raportet e testimit te paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nuk janë paraqitur në gjuhën shqipe, ashtu sikurse është kërkuar në dokumentat e tenderit, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor. Për më tepër që nuk janë të përkthyer të paktën vetëm ato pjesë të katalogut që kanë të bëjnë me përshkrimin apo specifikimet teknike të mallit apo produktit të kërkuar, pasi katalogu nuk përmban vetëm të dhëna teknike (si përmasa etj), por përmban edhe karakteristika teknike të shprehura e shpjeguara me përshkrim. Gjithashtu raportet e testimit detyrimisht duhet te ishin te perkthyer ne gjuhen shqipe referuar baze ligjore ne fuqi pasi gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe dhe raportet e testimit pershkruajnë të gjitha specifikimet teknike te bojës që do të përdoret nga operatorët ekonomik

per realizimin e shërbimit.

Në sa më sipër, komisioni i vleresimit te ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Meni” shpk nuk përmban raporte testimi dhe katalog me të dhënat e nevojshme dhe të mjaftueshme për artikujt e prokuruar.

4. Operatori ekonomik “Hysi-2F” shpk

- Kamioni me targe TR 3462U ka kapacitet mbajtës 2,4 ton nderkohe qe komisioni i vlerësimit te ofertave konstaton se ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar mjet me kapacitet mbajtës deri ne 2 ton. Komisioni i vleresimit te ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur gjykon se ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 pesha 4.6 ton perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar Nr.24 te lejes së qarkullimit të mjetit pesha 2.2 ton perfaqeson peshen e vetë mjetit të gatshem për lëvizje.

Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshen e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”

Ne vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vleresimit te ofertave vlerëson se kapaciteti mbajtës i mjetit të mësipërm është 2.4 ton duke mos plotësuar kriteret e vecanta per kualifikim pika 2.3.6 ku kapaciteti mbajtës është kërkuar deri ne 2 ton.

- Operatori ekonomik “Hysi 2F” nuk ka paraqitur raportet e testimi nga laboratore te certifikuar ku te vertetohet se specifikimet teknike te bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotësuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
- Ne lidhje me shërbimet e ngjashme operatori ekonomik “Hysi 2F” shpk ka paraqitur kontratën për punë publike te lidhur me Ministrinë e Mbrojtjes Nr.2689/1, date 27.05.2016 me objekt “Rikonstruksion i objektit Nr.10 (godina 2 kate), Babrru”. Referuar situacionit te punimeve komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se ne te perfshihen punime dheu, punime betoni dhe betonarme, punime dyer dritare, punime elektrike etj te cilat nuk mund te konsiderohen te ngjashme me shërbimin që është kërkuar në objektin e prokurimit. Referuar kësaj kontrate dhe situacionit perfundimtar në zërat e ngjashem të shërbimit me objektin tone te prokurimit konsiderohet zëri “Punime bojatisje” ne tërësinë e tij. Vlora e ketij zëri ne kontraten e paraqitur është në shumen 313.440 leke pa tvsh duke mos plotësuar shumen e kerkuar ne “Kriteret e vecanta per kualifikim”, Kapaciteti teknik pika 2.3.1 per sherbime te meparshme te ngjashme ne vleren 1.456.924 leke pa tvsh.

5. Operatori ekonomik “Cara” shpk

Operatori ekonomik Cara shpk për bojrat që do të perdore ka paraqitur një kontratë furnizimi me “Granitis” shpk me Nr.4392Rep, Nr 3455Kol, date 17.05.2017 me anë të së cilës shoqëria “Granitis” shpk merr përsipër furnizimin me bojra për Operatorin ekonomik Cara shpk. Por për bojrat që do të furnizohen nga Granitis shpk dhe do të perdoren për realizimin e procesit nuk janë paraqitur kataloget, skemat teknike si dhe raportet e testimi nga laboratorë të çertifikuar ku të vërtetohet se specifikimet teknike të bojrave përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

6. Operatori ekonomik “Theos” shpk

- Operatori ekonomik Theos shpk ka paraqitur mjetin me targa AA 213 HD me kapacitet 700 kg në pronesi të shoqërisë “Sina 98” për mjetin e paraqitur nuk ka kontratë qeraje midis operatorit ekonomik “Theos” shpk dhe shoqërisë “Sina 98”. Është paraqitur në sistemin elektronik një kontratë qeraje midis operatorit ekonomik “Theos” shpk dhe shoqërisë “Sina 98” me Nr.325 Rep, Nr.4262 Kol, date 17.08.2016 por në këtë kontratë objekt i dhenies me qera janë mjetet me targa AA 528GX dhe TR 9744T për të cilat nuk është paraqitur dokumentacion.

Pra sa me sipër operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.6.

- Operatori ekonomik Theos shpk ka paraqitur skemat teknike për Bojrat Vitex Classik dhe Acrylon të cilat janë të papërkthyer në gjuhën shqipe dhe të pannoterizuara

Në njoftimin e kontratës pika 4.6 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar sa më poshtë:

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht
Tjetër		_____

Paraqitja e këtyre dokumentave të papërkthyer në gjuhën shqipe në kundërshtim me pikën IV.6 të Njoftimit të Kontratës në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.*

- Operatori ekonomik “Theos” shpk nuk ka paraqitur kataloget dhe raportet e testimi nga laboratore të certifikuar ku të vërtetohet se specifikimet teknike të bojrave që do të perdoren përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
- Operatori ekonomik “Theos” shpk nuk ka paraqitur FDP për muajin prill duke mos

plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 ku specifikisht kerkohet:Listëpagesat sipas formës që kërkoet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018 - Prill 2018 , shoqëruar këto dhe me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore.

- Ne lidhje me shërbimet e ngjashme operatori ekonomik Theos shpk ka paraqitur kontratën për punë publike te lidhur me Drejtorine e Policise se Qarkut Tiranë Nr.3082/B, date 21.07.2015 me objekt “Rikonstruksion i Salles operative Drejtoria e policies Qarku Tiranë”. Referuar situacionit te punimeve komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se ne kontrate peshen më te madhe e zene punime prishje, punime elektrike, punime kondicionim ventilimi etj te cilat nuk mund te konsiderohen te ngjashme me shërbimin që është kërkuar në objektin e prokurimit. Referuar kësaj kontrate dhe situacionit perfundimtar në zërat e ngjashem të shërbimit me objektin tone te prokurimit konsiderohet zërat e ljerjes se ambjenteve ne tërësinë e tij. Vlera e ketyre zërave të shërbimit ne kontraten dhe situacionin perfundimtar te paraqitur paraqitur ne total kapin Shumen 1.000.000 leke pa tvsh duke mos plotësuar shumen e kerkuar ne “Kriteret e vecanta per kualifikim”, Kapaciteti teknik pika 2.3.1 per sherbime te meparshme te ngjashme ne vleren 1.456.924 leke pa tvsh.

7. Operatori ekonomik “Altec” shpk

- Operatori ekonomik Altec shpk ka paraqitur mjetin me targa AA 531 PK me kapacitet 810 kg ne pronesi te tij por per mjetin e paraqitur nuk ka Certifikaten e pronesise se mjetit sikunder kerkohet ne kriteret e vecanta per kualifikim , kapaciteti teknik pik 2.3.6 ku specifikohet sa me poshte:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera Kamionçine cope 1(një) me kapacitet deri ne 2 ton për transportin e mallit dhe mbeturinave.

Për mjetin duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, certificate pronesie dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik ka paraqitur dhe mjetin me targa TR 5269K te marre me qera nga shoqeria Xherald- sh me kontrate qeraje Nr. 812 Rep, Nr.314/1 kol.

Komisioni i vleresimit te ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur gjykon se ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 pesha 14000 kg perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar Nr.24 te lejes së qarkullimit të mjetit pesha 9020 kg perfaqeson peshen e vetë mjetit të gatshem për lëvizje.

Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshen e vetë mjetit të

gatshëm për lëvizje”

Ne vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vleresimit te ofertave vlerëson se kapaciteti mbajtës i mjetit të mësipërm është 4980 kg ose 4.98 ton duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim pika 2.3.6 ku kapaciteti mbajtes i mjetit është kërkuar deri ne 2 ton.

Pra sa me sipër për te dy mjetet e paraqitura nuk plotesohen kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.6 te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne dokumentat e tenderit.

- Operatori ekonomik “Altec” shpk ka paraqitur katalogun e bojrave Vechro ne gjuhen shqipe, skedat teknik jane paraqitur per Smaltoplast 100% Acrylic dhe Isomat professional Classic te paperkthyer dhe te panoterizuara

Në njoftimin e kontratës pika 4.6 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar sa me poshte:

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht
Tjetër	_____	

Paraqitja e këtyre dokumentave të papërkthyer në gjuhen shqip bie në kundërshtim me pikën IV.6 të Njoftimit të Kontratës në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*.

- Operatori ekonomik “Altec” shpk nuk ka paraqitur raportet e testimit nga laboratore të certifikuar ku të vërtetohet se specifikimet teknike të bojrave permbushin specifikimet teknike të percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

8. Operatori ekonomik “2 N” shpk

- Ne kriteret e vecanta per kualifikim , kapaciteti teknik pik 2.3.6 specifikohet sa me poshte:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera Kamionçine cope 1(një) me kapacitet deri ne 2 ton për transportin e mallit dhe mbeturinave.

Për mjetin duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, certificate pronësie dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ne plotesim te kesaj pike operatori ekonomik ka paraqitur mjetin me targa AA 948 HS ne

pronesi te tij.

Komisioni i vleresimit te ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur per kete mjet gjykon se ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 pesha 8000 kg perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar Nr.24 te lejes së qarkullimit të mjetit pesha 3670 kg perfaqeson peshen e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje.

Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është :

“Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshen e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”

Ne vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vleresimit te ofertave vlerëson se kapaciteti mbajtës i mjetit të mësipërm është 4330 kg ose 4.33 ton duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim pika 2.3.6 ku kapaciteti mbajtes i mjetit është kërkuar deri ne 2 ton.

- Operatori ekonomik “2N” shpk nuk ka paraqitur FDP per muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 ku specifikisht kerkohet:

Listëpagesat sipas formës që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018 - Prill 2018 , shoqëruar këto dhe me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore.

- Operatori ekonomik “2 N” shpk nuk ka paraqitur kataloget si dhe raportet e testimiit nga laboratore te certifikuar ku te vertetohet se specifikimet teknike te bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.

9. Operatori ekonomik “Deutchcolor” shpk

- Operatori ekonomik “Deutchcolor” shpk ka paraqitur raport e testimiit per bojrat te paperkthyer ne gjuhen shqipe dhe te panoterizuara.

Në njoftimin e kontratës pika 4.6 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar sa me poshte:

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip X Anglisht
Tjetër _____

Pra sa me siper Paraqitja e këtyre dokumentave të papërkthyer në gjuhen shqip bie në kundërshtim me pikën IV.6 të Njoftimit të Kontratës në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: “Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëhere dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.

- Operatori ekonomik “Deutchcolor” shpk ka paraqitur kataloget te paperkthyer ne gjuhen shqipe dhe te panoterizuara.
Në njoftimin e kontratës pika 4.6 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar sa me poshte:

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht
Tjetër		_____

Paraqitja e këtyre dokumentave të papërkthyer në gjuhen shqip bie në kundërshtim me pikën IV.6 të Njoftimit të Kontratës në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëhere dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*.

- Operatori ekonomik “Deutchcolor ” shpk nuk ka paraqitur FDP per muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill duke mos plotësuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 ku specifikisht kerkohet:

Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018 - Prill 2018 , *shoqëruar këto dhe me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore.*

10. Operatori ekonomik “Tea - D” shpk

- Ne lidhje me shërbimet e ngjashme operatori ekonomik Tea-D ka paraqitur kontratën për punë publike te lidhur me Bashkinë Gjirokaster Nr.4966 Prot, date 10.08.2017me objekt “Rikonstruksion i ambjenteve te brendshme dhe te jashtme (sistemime hidrosanitare, sistemime elektrike, dyer dritare, suvatime lysterje) shkolla dhe kopshte ”. Referuar situacionit te punimeve komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se ne kontrate referuar situacionit perfundimtar në zërat e ngjashem të shërbimit me objektin tone te prokurimit konsiderohet zërat e lysterjes se ambjenteve ne tërësinë e tyre. Nga përllogaritja e ketyre zerave sipas situacionit komisioni konstaton se vlera e këtyre zërave ne total kap shumen 746.650 leke pa tvsh duke mos plotësuar shumen e kerkuar ne “Kriteret e vecanta per kualifikim”, Kapaciteti teknik pika 2.3.1 per sherbime te meparshme te ngjashme ne vleren 1.456.924 leke pa tvsh.
- Operatori ekonomik “Tea-D ” shpk nuk ka paraqitur FDP per muajin Prill duke mos plotësuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 ku specifikisht kerkohet:

Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018 - Prill 2018 , *shoqëruar këto dhe me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore.*

- Operatori ekonomik “Tea-D ” shpk ka paraqitur nje kontrate furnizimi me shoqërine “Daylux” me Nr.441 Rep, Nr.288 Kol, date 13.06.2017 per tu furnizuar me bojra nga kjo shoqëri por nuk ka paraqitur katalogun e bojrave me te cilat furnoizohet dhe me ane te te cilave do te realizoje procesin e punes duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
- Gjithashtu ne plotësim te pikës 2.3.5 operatori ekonomik nuk ka paraqitur raportet e testimit nga laboratore te certifikuar ku te vertetohet se specifikimet teknike te bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8.

11. Operatori ekonomik “O.B.Konstruksion” shpk

- Operatori ekonomik “OB Konstruksion” shpk ka paraqitur katalogun e bojrave, dhe skedat teknike te paperkthyer dhe te panoterizuara
Në njoftimin e kontratës pika 4.6 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar sa me poshte:

Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht
Tjetër		

Paraqitja e këtyre dokumentave të papërkthyer në gjuhën shqip bie në kundërshtim me pikën IV.6 të Njoftimit të Kontratës në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëhere dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*.

- Operatori ekonomik “OB Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur raportet e testimit nga laboratore te certifikuar ku te vertetohet se specifikimet teknike te bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
- Operatori ekonomik “OB Konstruksion ” shpk nuk ka paraqitur FDP per muajt Janar, Shkurt, Mars, Prill duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik pika 2.3.2 ku specifikisht kerkohet:

Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018 - Prill 2018 , shoqëruar këto dhe me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore.

- Ne lidhje me shërbimet e ngjashme operatori ekonomik OB Konstruksion ka paraqitur kontratën me subject privat me objekt “Ndertim dyqani kati I +Bodrumne pazarin e

Krujes ”. Referuar situacionit te punimeve komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se ne kontrate referuar situacionit perfundimtar nuk ka zera punimi te ngjashem me objektin e prokurimit “Lyerje me boje” mos plotësuar “Kriteret e vecanta per kualifikim”, Kapaciteti teknik pika 2.3.1 per sherbime te meparshme te ngjashme ne vleren 1.456.924 leke pa tvsh.

12. Operatori ekonomik “ 2 Z Konstruksion” shpk

- Operatori ekonomik “2Z Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur skedat teknike dhe raportet e testimi nga laboratore te certifikuar ku te vertetohet se specifikimet teknike te bojrave permbushin specifikimet teknike te percaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8 duke mos plotësuar Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.5.
- Ne lidhje me shërbimet e ngjashme operatori ekonomik 2Z konstruksion ka paraqitur kontratën për punë publike te lidhur me Njesia operative Fier/OST sha me Nr.728 Prot, date 06.10.2017me objekt “Punime rehabilituese ne N/Stacionet Fier dhe Babice”. Referuar situacionit te punimeve komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se ne kontrate referuar situacionit perfundimtar në zërat e ngjashem të shërbimit me objektin tone te prokurimit konsiderohet zërat e lyerjes se ambjenteve ne tërësinë e tyre. Nga përlllogaritja e ketyre zerave sipas situacionit komisioni konstaton se vlera e këtyre zërave ne total kap shumen 530.270 leke pa tvsh duke mos plotësuar shumen e kerkuar ne “Kriteret e vecanta per kualifikim”, Kapaciteti teknik pika 2.3.1 per sherbime te meparshme te ngjashme ne vleren 1.456.924 leke pa tvsh.

Referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Gentian Horieti**” **person fizik** me adresë kryesore:Adresa:Rruga 5 Maji, ish NPK, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme pa TVSH= **3.476.346 (tremilion e katërqind e shtatedhjetë e gjashtëmijë e treqind e dyzet e gjashtë)** është identifikuar **sioferte e sukseshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tirane , sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit te këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bere me date 01.06.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të pikës 2 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78, pika 5 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, më datë 06.06.2018 është paraqitur ankesë me shkrim nga operatori ekonomik “Meni” shpk hyrë në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme me Nr.288 Prot, datë 06.06.2018. Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave te Mesme në mbështetje të pikës 3 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X “ “Shqyrtimi i ankesave”, Neni 78 nga Titullari i Autoritetit kontraktor u vendos pezullimi i procedurës me “Urdhër për pezullim procedure” Nr. 364 prot, datë 06.06.2018 dhe me Urdhër Nr.365 Prot, datë 06.06.2018 është ngritur grupi i shqyrtimit të ankesave i cili ka marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “Meni” shpk.

Pasi është marrë në shqyrtim ankesa e operatorit ekonomik “**Meni**” shpk dhe pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri nga grupi i shqyrtimit të ankesave nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “**Meni**” shpk dhe statusi i këtij operatori ekonomik mbetet i skualifikuar duke lene në fuqi vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar titullarit të autoritetit kontraktor me shkresën Nr.374 Prot, datë 08.06.2018 si dhe është vënë në dijeni shoqëria me ane të shkresës Nr.376 Prot, datë 08.06.2018

Operatori ekonomik “Meni” shpk në mbështetje të pikës 6 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) shpk nuk ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të pikës 2 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78, pika 5 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, më datë 06.06.2018 është paraqitur ankesë me shkrim nga operatori ekonomik “Erges Mat” shpk hyrë në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme me Nr.289 Prot, datë 06.06.2018. Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme në mbështetje të pikës 3 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) vendosi që grupi i shqyrtimit të ankesave i ngritur me Nr. __. Date i cili është ngarkuar nga titullari i autoritetit kontraktor për shqyrtimin e gjithë ankesave që do të paraqiten për kështu procedurë të shqyrtimit të ankesës duke e operatorit ekonomik “Erges Mat” shpk.

Pasi është marrë në shqyrtim ankesa e operatorit ekonomik “**Erges Mat**” shpk dhe pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri nga grupi i shqyrtimit të ankesave nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “**Erges Mat**” shpk dhe statusi i këtij operatori ekonomik mbetet i skualifikuar duke lene në fuqi vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar titullarit të autoritetit kontraktor me shkresën Nr. 375 Prot , datë 08.06.2018 si dhe është vënë në dijeni shoqëria me ane të shkresës Nr.377 Prot, datë 08.06.2018

Operatori ekonomik “Erges Mat” shpk në mbështetje të pikës 6 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) shpk ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik me datë 13.06.2018 dhe ka vënë në dijeni autoritetin kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme me ane të shkresës hyrese Nr.1109, datë 18.06.2018.

Komisioni i Prokurimit publik me ane të shkresës Nr.1109/1, datë 18.06.2018 hyre në institucion me shkresën Nr.310, datë 20.06.2018 ka urdhëruar autoritetin kontraktor të mbajë të pezulluar procedurën dhe të dërgojë informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Me ane të

shkresës Nr.392, datë 25.06.2018 Autoriteti Kontraktor i ka dërguar informacionin e kërkuar Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të Vendimit Nr.568/2018 hyre në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme me Nr.387 Prot, date 03.09.2018 vendos të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erges Mat” shpk dhe te lejoje Autoritetin Kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Me respekt,

